



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenin 9.1 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.02-401-11923, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE KLUBIN E XHUDOS“ LLAPI” NË PODUJEVË

Neni 1

Klubi i xhudos “Llapi” në Podujevë, për përmbushjen e obligimeve për kuotizim në Federatën e Xhudos të Kosovës për vitet 2015 dhe 2016, mbështetet me mjete buxhetore në shumë 200,00 €.

Neni 2

Mjetet buxhetore sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve n’kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e Federatës së Xhudos të Kosovës.

Neni3

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Nr. 02-066-22429

Podujevë,

21 prill 2016

Kryetari i Komunës
Agim Veliu